

Qendra e Personel Rekrutimit, ka filluar regjistrimin e kandidatëve për të ndjekur studimet ushtarake në Akademitë Ushtarake në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (Akademinë e Forcave Ajrore, Akademinë e Forcave Detare dhe Akademinë West Point) për vitet akademike 2018 - 2022, për **3 (tre)** të drejta studimi.

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë QPR-së është deri në **08 nëntor 2017**.

1. Kriteret e pranimit të kandidatëve:

- Të ketë shtetësi shqiptare.
- Të ketë kryer arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë.
- Të mos jetë i dënues apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë.
- Të jetë në moshë jo më pak se 18 vjeç dhe jo më shumë se 22 vjeç, në ditën e fillimit të vitit akademik.
- Të mos jetë i martuar.
- Të jetë i aftë nga ana shëndetësore.
- Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm nga të gjitha pikëpamjet, pa asnjë mangësi apo shenja që deformojnë pamjen.
- Të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 170 cm për meshkujt dhe jo më pak se 165 për femrat.
- Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme) të tjera; të mos ketë kaluar apo të vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepatike, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe lëvizjes) apo të ketë qenë ose jetë përdorues i lëndëve narkotike.
- Kandidatët që do të aplikojnë për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit të kenë notën mesatare të ponderuar të arsimit parauniversitar, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave, 6 (gjashtë).
- Kandidatët duhet të zotërojnë gjuhën angleze në të lexuar, të shkruar dhe të folur dhe të sigurojnë mbi 70 pikë në testimin ALCPT. Ata duhet të jenë të regjistruar për zhvillimin e testeve online të TOEFL, SAT ose ACT.
- Kandidatët nuk mund të regjistrohen për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit, në rast se:
 - a) Zotërojnë diplomë ushtarake për nivelin arsimor për të cilin aplikojnë;
 - b) Kanë fituar më parë statusin e studentit ushtarak;
 - c) Kanë qenë kontingjent i Forcave të Armatosura për ndjekjen e studimeve ushtarake brenda dhe jashtë vendit dhe nuk i kanë përfunduar studimet.
- Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përmendura më sipër, skualifikohet.

2. Dokumentet për regjistrim:

Kandidatët për regjistrim duhet të paraqesin pranë Zyrës së Rekrutimit dhe Pranimit Tiranë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati për ndjekjen e studimeve ushtarake në SHBA, ku të specifikohet institucioni arsimor dhe preferenca e degës për të cilën aplikohet.
- Formular me të dhënat personale sipas formatit të përcaktuar, **Anex A**.
- Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit parauniversitar së bashku me listën e notave, e cikluar nga Drejtoria Arsimore e Rrethit që ka lëshuar diplomën.
- Fotokopje e kartës së identitetit.
- Certifikatë familjare 1 (një) copë.
- Fotografji për dokument (4x6), 2 (dy) copë.
- Fotokopje të pasaportës e vlefshme për jashtë shtetit.
- Një raport ose vërtetim nga mjeku i familjes ku deklarohet se kandidati është klinikisht i shëndetshëm dhe grupin e gjakut.
- Dokument i cili vërteton se aplikanti është regjistruar për testimet që zhvillohen online për TOEFL, SAT, ose ACT.
- Certifikatë për TOEFL, SAT ose ACT.

Nëse kandidati shpallet fitues duhet të sjellë edhe dokumentet e mëposhtme:

- Dëshmi penaliteti.
- Vërtetim nga gjykata që nuk është në proces gjyqësor.
- Vërtetim nga prokuroria që nuk është në proces hetimi.
- Vërtetim nga përmbarimi.

Dokumentet mjekësore.

1. Raportin mjekësor të lëshuar nga Komisioni mjeko – ligjor (formularët mjekësorë “Form DD 2807-1 dhe Form DD 2808) nga Njësia Mjekësore Ushtarake.
2. Ekzaminimet për agjentët infektivë (Hepatit B, Hepatit C, HIV/AIDS), të lëshuar nga Njësia Mjekësore Ushtarake.

Në momentin e aplikimit pranë zyrës së pranimit në Qendrën e Personel Rekrutimit çdo kandidatë duhet të plotësojë një formular vetë deklarimi për gjendjen e tij shëndetësore.

3. Datat e testimit:

Testi Fizik:	09.11.2017
Testi i Gjuhës së Huaj:	09.11.2017
Testi Intelektual:	10.11.2017
Testi Psikologjik:	10.11.2017

4. Të dhënat tabelore të Testimit të Aftësive Fizike:

MESHKUJ

NORMAT	Tërheqje në Hekur		Hedhje e Top-Bask		Vrapim shpejt. 36m (40 -yard)		Muskuj-Barku		Ulje-Ngritje mbi duar		Vrapim 1600m (One Mile Run)	
	SAS	PIKE	SAS	PIKE	KOHA	PIKE	SAS	PIKE	SAS	PIKE	KOHA	PIKE
Max	18	50	31m	50	7.8'	50	95	50	75	50	5:20	50
	17	45	29	45	8	45	93	45	73	45	5:32	45
	16	40	27	40	8.2	40	91	40	71	40	5:44	40
	15	35	25.5	35	8.4	35	88	35	68	35	5:57	35
	14	30	24	30	8.6	30	85	30	65	30	6:10	30
	13	27	22.5	27	8.75	27	83	27	63	27	6:23	27
Min	12	25	21m	25	8.9'	25	81	25	61	25	6:36	25

FEMRA

NORMAT	Tërheqje në Hekur		Hedhje e Top-Bask		Vrapim shpejt. 36m (40 -yard)		Muskuj-Barku		Ulje-Ngritje mbi duar		Vrapim 1600m (One Mile Run)	
	SAS	PIKE	SAS	PIKE	KOHA	PIKE	SAS	PIKE	SAS	PIKE	KOHA	PIKE
Max	7	50	20m	50	8.6'	50	95	50	50	50	6:00	50
	6	45	19	45	9'	45	92	45	48	45	6.23	45
	5	40	17	40	9.2	40	88	40	46	40	6.47	40
	4	35	15	35	9.4'	35	83	35	44	35	7.11	35
Min	3	25	12.5m	25	9.7'	25	78	25	41	25	7:35	25